



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1564/Prot.
8

Pogradec, më 26. 04. 2023

VENDIM

NR. 42, DATË 25. 04. 2023

**“PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 92, DATE 27.08.2020 PËR SAKTËSIMIN
E SIPËRFAQEVE TË PASURIVE SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË
TERRITORIT NR 18, DATË 23.02.2008”**

Në mbështetje të; nenit 8, shkronja”a” dhe “c” të pikës 1.2 të nenit 9, nenit 54 Nr.139/2015, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 16 të Ligjit Nr.111/2018, “Për kadastrën”, Ligjit Nr 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 6 të Ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore ”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1240, datë 10.9.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Pogradec, të Qarkut Korçës”, i ndryshuar, për efekt regjistrimi dhe korigjimi në të dhënat kadastrale me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të shtojë në pikën 1 të Vendimit nr 92, datë 27.08.2020 objektet “Rikonstruksion shëtitore Fan Noli”, “Sistemim Shëtitore Dëshmorët e Pojskës” si dhe të gjitha objektet publike të përfshira në Vendimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit Nr. 36, datë 01.02.2005.
2. Të miratojë saktësimin e sipërfaqeve të pasurive të ndodhura në territorin e bashkisë Pogradec sipas vendimeve për lejë ndertimi të dhëna nga Këshillat e Rregullimit të Territorit
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Sektori i Aseteve pranë Bashkisë Pogradec
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT
Sotiraq MANGËRI

